

## ANALIZË

### (Kuari institucional dhe ligjor për menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri)



#### **Menaxhimi i burimeve ujërave në Bashkinë Kukës**

*Ky dokument është përgatitur nga ACER në kuadër të projektit “Uji i Pastër në Gjakovë dhe Kukës”.*



Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)

Gusht, 2021

## Tabela e Pëmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive .....	3
Hyrja .....	4
1. Kuadri institucional.....	4
1.1 Niveli Qëndror.....	4
1.2 Niveli lokal .....	7
2. Kuadri ligjor.....	8
2.1 Legjislacioni parësor.....	8
2.2 Legjislacioni dytësor (aktet nënligjore) .....	8
2.3 Legjislacioni ndër-sektorial .....	9
2.4 Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare .....	10
2.5 Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2018-2027 .....	10
2.6 Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030 .....	11
3. Menaxhimi i burimeve ujore në bashkinë Kukës.....	12
3.1 Pasuria Hidrike dhe vlerat e Përdorimit të Ujit .....	12
3.1.1 Ujësjellës-Kanalizime Ndërmarrja e ujësjellës-kanalizime Kukës .....	15
3.1.2 Cilesia e Ujrave Sipërfaqësore .....	18
3.1.3 Ujrat Nëntokësorë .....	18
3.2 Struktura organizative e menaxhimit të ujërave në Bashkinë e Kukësit .....	21
3.3 Analiza e treguesëve të performancës së shoqërisë UK Kukës .....	22
4. Problematikat kryesore në lidhje me menaxhimin e ujit në Shqipëri .....	23
4.1 Mangësitë institucionale.....	23
4.2 Mangësitë e të dhënave dhe informacionit .....	24
4.3 Mangësitë financiare.....	24
4.4 Mangësitë ligjore .....	24
4.5 Mangësitë në kapacitete.....	25
4.6 Mangësitë në angazhimin e grupeve të interesit.....	25
4.7 Problemetikat kryesore të sektorit të Ujësjellës-Kanalizime në Bashkinën Kukës .....	25
Konkluzionet dhe Rekomadimet.....	26
Konkluzionet.....	26
Rekomandime .....	27
Referencat .....	28
Anekset .....	29

## Përmbledhje ekzekutive

Menaxhimi i ujit në Shqipëri bazohet në një qasje gjithëpërfshirëse, ku marrin pjesë përdoruesit, planifikuesit dhe politikëbërësit e të gjitha niveleve. Nga pikëpamja institucionale, menaxhimi i burimeve ujore në Shqipëri është pothuajse i centralizuar, rezultat i veprimtarisë joefikase dhe mungesës së transparencës ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe atij vendor.

Për të siguruar një menaxhim sa më të mirë të burimeve ujore, në vitin 2012 është miratuar Ligji Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore i cili ka për qëllim mbrojtjen, përmirësimin e mjediseve ujore dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit. Ky ligj mbështet nga legjislacioni dytësor dhe ndërsektorial.

Rolet në sektorin e burimeve ujore janë shpërndara në institucione të shumta: Këshilli Kombëtar i Ujit i mbështetur nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU), në Nivel Kombëtar dhe Autoriteti Kombëtar i Ujesjelles Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), Këshillat e Basenit Ujor dhe Agjencitë në Nivel Baseni në Nivel Lokal. AKUM është autoriteti ligjor dhe teknik që koordinon dhe monitoron shoqëritë e licensuara për sigurimin e furnizimit me ujë, kanalizimeve të ujërave të përdorura dhe trajtimin e tyre për të gjithë popullsinë e vendit, në bashkëpunim me pushtetet vendore.

Spektori i Ujesjellës- Kanalizimeve (UK) funksionon kryesisht nëpërmjet operatorëve të organizuar si shoqëri aksionare me pronar pushtetin vendor. Aktualisht në sektor operojnë 57 operatorë, 53 prej tyre janë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit dhe 48 operojnë me tarifa të miratuara nga Enti Rregullator i Ujit (ERU). Spektori i UK është zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme, ndonëse nivelet dhe ecuria e treguesve nuk është e duhura krahasuar me objektivat strategjike për sektorin të parashikuara në Strategjinë Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2018-2027. Shërbimi me kanalizime nuk ofrohet nga të gjithë operatorët. Ky shërbim në sektor është ofruar nga 32 operatorë, 5 prej të cilëve kryejnë edhe trajtimin e ujërave të ndotura. Shqetësimi kryesor në sektor është niveli i lartë i humbjeve, tregues i cili nuk ka pasur një përmirësim të dukshëm. Enti Rregullator ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve, edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve kërkon kohë dhe investime.

## Hyrja

Shqipëria është një vend i pasur me burime ujore, dhjetëra lumenj, tre liqene të mëdhenj të lundrueshëm dhe ndërkuftarë, një numër të madh ligatinash të rëndësishme dhe burime të shumta ujërash nëntokësore. Pavarësisht kësaj pasurie ujore, Shqipëria përballet me probleme të shumta lidhur me menaxhimin e burimeve ujore, ndikimin e pasojave të ndryshimeve klimatike (rritjen e temperaturës dhe uljen e sasisë së reshjeve). Burimet ujore pritet të ulen me 14% deri në vitin 2050<sup>1</sup>. Për të siguruar një menaxhim sa më të mirë të burimeve ujore, në vitin 2012 është miratuar **Ligji Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”**<sup>2</sup> i cili ka për qëllim mbrojtjen, përmirësimin e mjediseve ujore dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit. Ky ligj është përafëruar plotësisht me: Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2000, “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”

Nga pikëpamja institucionale, **menaxhimi i burimeve ujore në Shqipëri është pothuajse i centralizuar**, rezultat i veprimtarisë joefikase dhe mungesës së transparencës ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe atij vendor.

**Spektori i Ujësjellës- Kanalizimeve(UK)** është zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme, ndonëse nivelet dhe ecuria e treguesve nuk është e duhura krahasuar me objektivat strategjike për sektorin dhe ato të performancës.

**Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)** është autoriteti ligjor dhe teknik që koordinon dhe monitoron shoqëritë e licensuara për sigurimin e furnizimit me ujë, kanalizimeve të ujërave të përdorura dhe trajtimit të tyre për të gjithë popullsinë e vendit, në bashkëpunim me pushtetet vendore.

**Shqetësimi kryesor** në sektor është **niveli i lartë i humbjeve**, tregues i cili nuk ka pasur një përmirësim të dukshëm. Enti Rregullator ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve, edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve kërkon kohë dhe investime.

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë ka pasur tendencë pozitive por shërbimi i kanalizimeve vazhdon të mbetet prapa si për sa i përket mbulimit po ashtu edhe nivelit të kërkuar të shërbimit për të mundësuar mbrojtjen e ujërave dhe të mjedisit.

**Burimet kryesore të financimit për shoqëritë**, ka qenë buxheti i shtetit dhe financimi nga donatorët e huaj në formën e huave apo granteve në raporte përafërsisht të barabarta. Këto investime janë fokusuar kryesisht në rehabilitimin e sistemeve të furnizimit ujësjellës kanalizime si edhe në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

## 1. Kuadri institucional

### 1.1 Niveli Qendror

Strukturat e administrimit dhe menaxhimit të ujërave janë të disponueshme në nivel kombëtar dhe vendor. Çdo organ ka detyrat dhe përgjegjësitë e tij për ruajtjen, promovimin dhe menaxhimin e burimeve ujore bazuar në legjislacionin përkatës.

<sup>1</sup> Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2017 [\[link\]](#)

<sup>2</sup> Ligji Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” [\[link\]](#)

Organet/ Institucionet përgjegjëse janë si mëposhtë:

Në nivel kombëtar, *Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU)* është organi ekzekutiv qendror. KKU-ja mbështet nga *Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)*.

Në shkurt të vitit 2015, përgjegjësia e “Drejtorisë së Politikave të Ujërave” kaloi nga *Ministria e Mjedisit në varësinë e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural (MBZHR)*. Kjo ministri është përgjegjëse për menaxhimin e vatitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytjet.

*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)* përgatit politika dhe strategji për furnizimin me ujë dhe sektorin për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza.

*Autoriteti Kombëtar i Ujesjelles – Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)* është një institucion që raporton te MTI-ja, duke qenë se është e specializuar në furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbetjeve. MIE luan një rol të rëndësishëm në sektorin e ujërave; duke qenë se ajo është përgjegjëse për prodhimin e energjisë hidrike, që përfaqësojnë mbi 97% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike.<sup>3</sup>

*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSH)* ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor. Ajo është përfshirë në zbatimin e legjislacionit për sektorin e ujërave nëpërmjet Strukturave Rajonale të Shëndetit Publik, Inspektoratit Sanitar Shtetëror dhe Institutit të Shëndetit Publik .

*Ministria e Mbrojtjes (MB)* kryen aktivitetet e saj sipas legjislacionit për parandalimin, reduktimin dhe lehtësimin e efekteve negative të emergjencave civile mbi popullsinë, bagëtitë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)* akordon, bazuar te prioritetet e qeverisë, burime financiare për sektorin e ujërave, duke i dhënë prioritet menaxhimit të duhur të burimeve ujore për përmbushjen e nevojave të shoqërisë.

*Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)*, nën varësinë e Ministrisë së Mjedisit, është përgjegjëse për monitorimin cilësor dhe sasior të burimeve ujore.

*Instituti i Gjeo-Shkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit*, (ish Instituti Hidro-meteorologjik), nën varësinë e Ministrisë së Arsimit, monitoron parametrat hidro-meteorologjik dhe është përgjegjës për kryerjen e monitorimit të sasisë së ujërave sipërfaqësore për lumenjtë dhe liqenet.

*Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)*, nën varësinë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, është përgjegjës për monitorimin cilësor të ujërave nëntokësore dhe detare, vlerësimin e rrezikut dhe monitorimin e ndotjes së tokës;

*Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore*, e cila është nën varësinë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, përqendrohet në monitorimin e hidrocentraleve;


*Instituti i Shëndetit Publik* nëpërmjet strukturave vendore, si Drejtoria e Shëndetit Publik (Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë) monitoron higjienën dhe cilësinë e ujit të pijshëm.

---

<sup>3</sup> KM (2017) Vendimit nr. 437, datë 17.05.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe kullimit, Bordet Rajonale të Kullimit do të jenë Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit. Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit janë në Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë.

*Enti Rregullator i Ujit* është një institucion i pavarur, i krijuar nga Parlamenti. Detyrat kryesore përfshijnë lëshimin e licencave për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizime, miratimin e tarifave për ujë të pijshëm dhe monitorimin e aktiviteteve që lidhen me furnizimin me ujë dhe kanalizimet.<sup>4</sup>

- Licenson persona fizikë apo juridikë, që ofrojnë shërbimin ujësjellës-kanalizime për përfitim publik;
- Siguron që operatorët t'ju ofrojnë konsumatorëve shërbime me cilësi të mirë dhe efikase dhe me një çmim të arsyeshëm;
- Përcakton tarifën e shërbimit, në mënyrë që të sigurojmë qëndrueshmërinë financiare të operatorëve si dhe përballimin e tyre nga klientët;
- Monitoron performancën e operatorëve duke siguruar zbatimin e masave për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe duke nxitur progresin e vazhdueshëm të shërbimit, përmes vendosjes së objektivave efikasë dhe sfidues;
- Siguron që operatorët bëjnë më të mirën për klientët dhe mjedisin në vështrim afatgjatë;
- Analizon ankesat e konsumatorëve dhe i mbështesin ata në zgjidhjen e tyre ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve;
- Kontribon me komentet tona në të gjitha proceset e rëndësishme në sektor si në hartimin e strategjive, politikave dhe legjislacionit kombëtar për sektorin ujësjellës kanalizime;
- Rregullisht harton dhe vë në dispozicion informacion mbi sektorin ujësjellës kanalizime për të gjithë aktorët në sektor dhe publikun e gjerë p.sh. përmes raporteve Vjetore dhe të Performancës<sup>5</sup>.



**Figurë 1.** Struktura organizative e institucionale për menaxhimin e burimeve ujore

<sup>4</sup> Bazuar në Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2017[[link](#)] por edhe në faqet online të institucioneve të përmendura më lartë.

<sup>5</sup> Enti Rregullator i Ujit, faqe online [[link](#)]

## 1.2 Niveli lokal

Organet lokale për menaxhimin e integruar të burimeve ujore janë:

a) *Këshillat e Baseneve Ujore;*

b) *Agjencitë e Baseneve Ujore.*

Shqipëria ndahet në shtatë basene ujore: baseni ujq Drin-Bunë, me qendër në Shkodër; baseni ujq Mat, me qendër në Lezhë; baseni ujq Ishëm, me qendër në Durrës; baseni ujq Erzen, me qendër në Tiranë; baseni ujq Shkumbin, me qendër në Elbasan; baseni ujq Seman, me qendër në Fier; baseni ujq Vjosë, me qendër në Vlorë<sup>6</sup>.

Secili basen ujq, ka një *Këshill për Basenin Ujq (KBU)* dhe një *Agjenci për Basenin Ujq (ABU)*. Secili nga Këshillat e Baseneve Ujq (KBU) kryesohet nga një prej Prefektëve përgjegjës dhe është i përbërë nga 9 deri në 23 anëtarë që përfaqësojnë ministrinë, NjQV-të, bizneset dhe konsumatorët e basenit.

Këshillat e Baseneve Ujq asistohen nga Agjencitë e Baseneve Ujq (ABU), që funksionojnë si një Sekretariat Teknik për KBU-në. Ato janë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Burimet Ujq. Ato ndërmarrin vlerësimin teknik të aplikimeve për përdorimin e ujit (ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe japin rekomandime për miratim nga KBU-të, mbështesin bashkitë për zgjidhjen e problematikave të lidhura me burimet ujore dhe janë përgjegjëse për inspektimin e të gjitha veprimtarive që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve ujore. Megjithatë, ABU-të kanë autoritet të kufizuar për të zbatuar procedurat ligjore dhe rregullatore.

Këshilli i Basenit Ujq është përgjegjës për:

- ruajtjen dhe zhvillimin racional të burimeve ujore brenda kufijve të basenit përkatës ujq;
- shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore brenda kufirit të basenit përkatës ujq, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre;
- mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë dhe sasinë e tyre identifikimin e trupave ujq përkatës që kanë nevojë për mbrojtje.

Këshilli i Basenit Ujq varet nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.

Në praktikë, takimet e KBU-së mbahen me dyer të hapura, ku publiku i gjerë dhe grupet e vegjël të përdoruesve mund të marrin pjesë në mënyrë shumë të kufizuar në proceset formale të menaxhimit të burimeve ujore<sup>7</sup>.

Organizimi institucional për ujitjen dhe menaxhimin e kullimit përfshin komunat/bashkitë si një lidhje e rëndësishme, që sjell si rezultat tre nivele menaxhimi:

Qeverisjen qendrore, ku MBZHR dhe Bordet e Kullimit kanë kompetencat më të larta të nivelit të administrimit mbi asetet parësore dhe digat;

Bashkitë si një nivel i ndërmjetëm administrimi për asetet dytësore dhe tretësore;

<sup>6</sup> Agjencia Telegrafike Shqiptare (2019) “ Shqipëria ndahet në 7 basene ujore, caktohen kufijtë territorialë e hidrografikë” Media Online, 30.10.2019 [[link](#)]

<sup>7</sup> Bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujqore [[link](#)]

Organizatat e përdoruesve të ujit dhe bashkimet e tyre si niveli më i ulët i administrimit.

## 2. Kuadri ligjor

Duke qenë se Shqipëria synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian, kuadri ligjor dhe baza e njohurive për përgatitjen, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave për menaxhimin e burimeve ujore duke të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi të BE-së.

Legjislacioni dhe rregulloret për menaxhimin e ujërave ndahen në katër seksione:

- legjislacion parësor;
- legjislacion dytësor;
- legjislacioni ndër-sektorial
- përputhshmëria me Direktivat e BE

### 2.1 Legjislacioni parësor

Ligjshmëria Ujore bazohet në Ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i cili mundëson:

***Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjediseve ujore***, ujërave sipërfaqësore, qoftë të përkohshme apo të përhershme, ujërat detare, ujërat territoriale, zonat ekonomike ekskluzive, ndarjet kontinentale, ujërat ndërkuftare, ujërat tokësore, dhe statusin e tyre;

***Sigurinë, mbrojtjen, zhvillimin dhe përdorim e qëndrueshëm të burimeve ujore***, të nevojshme për jetën dhe për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit;

***Shpërndarjen e barabartë të burimeve ujore***, ashtu si synohet nëpërmjet menaxhimit efektiv të tyre;

***Mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja***, mbi-përdorimi dhe promovimi i konsumit për nevojat aktuale;

***Krijimin e kuadrit institucional***, në nivel kombëtar dhe vendor, që kërkohet për zbatimin e politikës kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në përfitim të komuniteteve dhe sipas interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

Ligji Nr. 111/2012 përcakton dhe përkufizon përmbajtjen e dokumenteve të politikës së ujit, duke përfshirë: objektivin e planifikimit dhe zhvillimit të veprimeve për menaxhimin e ujërave sipas zhvillimit ekonomik, demografik, social, mjedisor, kulturor dhe historik; masat për zbatimin, planin operacional dhe krijimin e buxhetit të nevojshëm për zbatimin.

### 2.2 Legjislacioni dytësor (aktet nënligjore)

Ligji Nr. 111/2012 plotësohet me disa akte dytësore. Legjislacioni dytësor aktual për menaxhimin e ujërave (aktet nënligjore) përfshin:

- VKM Nr. 416, datë 13.5.2015, Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”;
- VKM Nr. 643, datë 14.9.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Shërbimet e Kanalizimeve”;
- VKM Nr. 1080, datë 18.12.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e këshillit Kombëtar të Ujit”;



- VKM Nr. 177, datë 26.03.2014 “Për krijimin dhe përbërjen, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e Komisionit Special për Menaxhimin e Ujërave Ndërkufitare”;
- VKM Nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara për shkarkimet e lëngshme dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”;
- VKM Nr. 125, datë 02.03.2006 “Për krijimin e KKKU”;
- Vendim Nr. 1080, datë 18.12.2013 “Për krijimin dhe përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit”;
- VKM Nr. 268, datë 6.4.2016; Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit”;
- VKM nr. 342, datë 4.5.2016 “Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”;
- Vendim i Kuvendit nr. 34/2016, datë 28.4.2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU);
- Vendim Nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”;
- Vendim Nr.28, datë 28.9.2011 Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave”;
- VKM Nr. 230, datë 23.4.2014 “Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit”;
- VKM Nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm”, që shfuqizon VKM Nr. 145, datë 26.02.1998 “Për miratimin e rregullores higjienike-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 7.2.2018 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027”.

### 2.3 Legjislacioni ndër-sektorial

- Ligji Nr.9115, datë 24.7.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura”
- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”
- Ligji Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
- Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar
- Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore"
- Ligji "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura.
- 2.4 Përputhshmëria me Direktivat e BE-së
- Ligji Nr. 111/2012 është në përputhje të plotë me:
  - COM (2009) 147 final – Raport për Kuadrin Evropian për Veprim;
  - SEC (2009) 386 - Raport - Dokument Shoqërues për Ujin;
  - DKU Dokument Udhëzues Nr. 24 - Menaxhimi i Ujëndarësit të Basenit në një Klimë në Ndryshim;
  - Direktiva 2000/118 / EC – Për ujërat nëntokësore;
  - SEC (2010) 166 final – Dokument Pune i Stafit si dokument shoqërues i Direktivës për Ujërat Tokësore;
  - SEC (2010) 1096 final – Raport për Direktivën e Ujërave Tokësore;
  - Direktiva 91/271 / EEC – Për ujërat e ndotura urbane;

- Direktiva 2008/105 / EC – Direktiva për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikës së ujërave;
- Direktivën 2000/60/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 23 Tetor 2000 "Për krijimin e një kuadri ligjor për veprimet komunitare në fushën e politikës së ujërave", i ndryshuar me Vendimin Nr. 2455/2001/EC, Direktiva 2008/32/EC.
- COM (2004) 472 – Komunikim për Menaxhimin e Riskut nga Përmbytjet – Parandalimi, Mbrojtja dhe Lehtësimi;
- COM (2007) 414 final – Komunikim për pamjaftueshmërinë e ujit dhe përmbytjet. Plan-Raport për Thatësitrat;
- COM (2007) 354 final – Raport paraprak për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- Ligji është pjesërisht në përputhje me:
- Direktivën 2006/118/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 12 dhjetor 2006 "Për mbrojtjen e ujërave tokësore ndaj ndotjes dhe dëmtimit", përkufizimi i "nivelit bazë". Pjesa e mbetur e kësaj Direktive është adaptuar plotësisht;
- Direktivën 2007/60/EC "Për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet", në lidhje me përkufizimin e termave "përmbytje" dhe "risk i përmbytjeve". Pjesa e mbetur e kësaj Direktive është adaptuar plotësisht.<sup>8</sup>

#### **2.4 Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare**

Qeveria e Shqipërisë ka lidhur marrëveshje me vendet fqinje, me qëllim zgjidhjen e çështjeve të menaxhimit të ujërave, si dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre vendeve për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare, për nevojën e forcimit të veprimit kombëtar dhe dypalësh, si dhe për parandalimin e ndotjes së burimeve ujore.

Theksojmë:

- Ratifikimin e marrëveshjes me shtetin Greqinë në vitin 2003, ku u mbajt vetëm një takim në vitin 2008, megjithatë palët janë në kontakte të vazhdueshme. Pavarësisht pritshmërive nga marrëveshja rezultatet ishin larg pritshmërive.
- Marrëveshjen ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut u nënshkrua për Liqenin e Ohrit "Për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe basenit të tij".
- Në vitin 2011 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi për "Lumin e Drinit: Një vizion strategjik i ndarë" ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Greqisë, Kosovës dhe Malit të Zi.

#### **2.5 Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2018-2027**

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore (MIBU) është një dokument i rëndësishëm i cili përcakton mënyrën e zbatimit të politikave të qeverisë, qëllimet dhe objektivat në fushën e menaxhimit të integruar të ujërave për një periudhë afatgjatë. Kjo strategji bazohet në hulumtime shkencore, vëzhgime të vazhdueshme të situatës dhe problematika që kanë lidhje me ujin dhe përdorimin e tij.

Strategjia MIBU përcakton 5 Objektiva Strategjike që kërkojnë një vëmendje të veçantë:

<sup>8</sup> Sipas "Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2017[[link](#)], por edhe legjislacionit të sipër përmendur.

**Sasia e ujit**- sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm i të gjitha burimeve ujore që i shërben të gjitha interesave, përmes aplikimit të akteve dhe nën-akteve ligjore kombëtare, të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së.

**Cilësia e ujit**- sigurimi i një cilësie të mirë të ujit të të gjitha burimeve ujore, duke arritur statusin e “gjendjes së mirë të ujit” deri në vitin 2027, përmes aplikimit të akteve dhe nën-akteve ligjore kombëtare të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së.

**Rreziqet nga uji**- ulja e rreziqeve që vijnë nga uji (përmbytjet dhe thatësirat) përmes menaxhimit dhe investimeve që i shërben të gjitha interesave, përmes aplikimit të akteve dhe nën-akteve ligjore kombëtare të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së.

**Informacion për ujin**- sigurimi i modeleve dhe të dhënave të njohura gjerësisht si të besueshme, rreth ujit dhe klimës për të gjitha palët e interesit dhe dhënien e këshillave qeverisë për hartimin e politikave për ujin duke u bazuar në institucionet respektive të cilat i zotërojnë këto të dhëna.

**Administrimi i ujit**- menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në shërbim të të gjitha interesave duke ofruar përfitime socio-ekonomike të barabarta nga përdorimi i ujit dhe përfshirja në vendimmarrje për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore MIBU dhe BE-së.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore rishikohet çdo 15 vjet. Strategjia mund të rishikohet dhe të përditësohet edhe para përfundimit të këtij afati, në qoftë se një gjë e tillë diktohet nga ndryshimet në sistemin e ujërave dhe zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit.<sup>9</sup>

## **2.6 Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030**

Strategji Sektoriale për Shërbimet Ujësjiellës/Kanalizime për periudhën 2020-2030 është përgatitur me qëllim për të paraqitur *vizionin, misionin, qëllimin e politikave dhe planet e veprimit në Shqipëri* në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore, në përputhje me Angazhimet e Vendit tonë drejt arritjes së Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Qëllimi i Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është të përmirësojë ofrimin cilësor të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për qytetarët e Shqipërisë dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit, bazuar në kryerjen e një shërbimi kryesor të infrastrukturës.

Kjo Strategji e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime do të shqyrtohet nga Këshilli i Ministrave për të bashkërenduar objektivat dhe prioritetet kryesore të sektorit UK në Republikën e Shqipërisë, si dhe hartimin e propozimeve për zbatimin dhe financimin e politikave, me qëllim arritjen e këtyre objektivave brenda periudhës 11 vjeçare të Strategjisë. Strategjia ndërthur gjetjet nga Konsultimet e Grupit Ndërmnistror të Punës dhe analizat përkatëse, duke përfshirë një vlerësim të detajuar të situatës aktuale, kuadrin ligjor dhe rregullator, shpenzimet publike të planifikuara dhe burimet e financimit për sektorin e ujit.<sup>10</sup>

<sup>9</sup> Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2017 [\[link\]](#)

<sup>10</sup> Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030 [\[link\]](#)

### 3. Menaxhimi i burimeve ujore në bashkinë Kukës

Qyteti i Kukësit shtrihet në Shqipërinë verilindore, në kufi me Republikën e Kosovës. Kukësi shtrihet rrëzë malit të Gjalllicës, me lartësi mbi detare 2489 metra mbi nivelin e detit si dhe buzë Liqenit të Fierzës, një liqen artificial i krijuar në fund të viteve të 70-ta.

Territori i bashkisë së Kukësit ka shumë burime ujore mjaft të rëndësishme për furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm. Kukësi është qyteti i dytë në Shqipëri me rezervat ujore më të mëdha pas Shkodrës. Burimet ujore të Bashkisë Kukës përfaqësohet nga rrjedhja e poshtme e Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, gjithashtu dhe degëve të tyre, si lumi i Lumës, i Bushtricës, përrenjëve të shumtë dhe një numër i madh burimesh nëntokësore kryesisht burime karstike. Baseni i Lumit Drin është më i madhi në vend dhe shtrihet në Shkodër, Kukës dhe në Rajonin e Dibrës.

Në Shqipëri, kuadri ligjor për menaxhimin e ujërave është i centralizuar në nivel qendror, prandaj edhe në nivel lokal, në bashkinë e Kukësit nuk ka dokumente rreth kësaj teme. Megjithatë, gjatë analizës së dokumenteve legjislative të miratuara, vërehet se mbrojtja dhe trajtimi i ujërave është tejet i rregulluar dhe mirë i menaxhuar.

Bashkia Kukës harton çdo vit planin e përgjithshëm vendor, ku pjesë përbërëse të tij planet e veprimeve lokale mjedisore (PVLMM) dhe programet për mbrojtjen e mjedisit<sup>11</sup>. Në përputhje me nenin 14, të ligjit të ujërave disa përgjegjësi për implementimin e politikës së ujërave janë deleguar te bashkitë. Këto përgjegjësi në veçanti kanë të bëjnë me lëshimin e licencave, të zbatojnë aktet nënligjore për licencat ujore.

#### 3.1 Pasuria Hidrike dhe vlerat e Përdorimit të Ujit

Hidrografia përfaqësohen nga ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilat janë të shumtë. Pasuritë ujore kanë vlera hidroenergjitike, për furnizimin me ujë të qendrave të banuara, aktivitetin industrial, për bujqësinë dhe turizmin. Hidrografia përfaqësohet nga rrjedhja e poshtme e Drinit të Zi, Drinit të Bardhë, Borjes, Topojani, Orgjostit. Rrjeti hidrografik është pjesë e pellgut ujëmbledhës të detit Adriatik. Lumenjt kanë regjim pluvio-nival me rrjedhje të qëndrueshme dhe potencial hidroenergjitik, ato kanë formuar lugina të thella malore, kanione, të cilat paraqesin vlera të veçanta turistike dhe mundësi për zhvillimin ekonomik. Burimet zënë një vend të rëndësishëm. Burimet kryesore janë: Kroi i Bardhë, Kinzës, Tanzotave, Kishëz etj.

**Drini i Zi** (149 km) buron nga liqeni i Ohrit, i cili pasi përshkon një rrugë të ngushtë prej 40 km midis vargmaleve Jabllanicë-Belicë-Karoman dhe merr shumë degë, hyn brenda në territorin tonë, ku hapet në një shtrat shumë të gjerë.

Në vazhdim lugina ngushtohet dhe zgjerohet, deri sa derdhet në liqenin e Fierzës. Këtu merr shumë degë, lumenj dhe përrenj malor (Zallin e Homoshit, përroin e Qafë- Murrës, përroin e Veleshicës, përroin e Banjave etj.)

**Drini i Bardhë (134 km)** buron nga malësia e Zhlebit në rrëzë të majës së Ruselit (Bjeshkët e Namuna të Kosovës), në trajtën e burimit karstik. Përshkon rrafshin e Dukagjinit, ku merr shumë degë si Toplugën, Bisticën e Prizrenit, Pejën, Ernikun, Mirushën dhe kalon në grykën e Morinit ku derdhet në liqenin e Fierzës. Relievi i pellgut ujëmbledhës është më pak i thyer dhe i copëtuar sesa ai i Drinit të Zi.

**Lumi i Lumës** - Buron nga mali i Koxhaballkanit. Gjatë rrjedhjes së sipërme mbledh ujërat e Rekës dhe Topojanit, përroit të Shishtavecit, të Kollovozit, Shtrezës. Në afërsi të urës së Zarifës bashkohet me

---

<sup>11</sup> Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kukës (Plani i zhvillimit) [\[link\]](#)

lumin e Orgjostit dhe Borjes, duke marr emrin lumi i Lumës. Ky lum është i rrëmbyer dhe ka prurje të mëdha gjatë vitit.

**Përroi i Tërshenës** është lum torrencial. Buron nga mali i Tejës. Lumë i vogël, me pak ujë, por i rrëmbyeshëm. Përshkon fshatin malor të Tërshenës prej të cilët ka marrë dhe emrin. Pret si thikë malin e Gjallicës dhe malin e Tejës, duke formuar grykën e skalitur 500-600 m të thellë që quhet Shkalla e Keqe (kanioni i Bicajve). Këtu kalon rruga që lidh pellgun e Bicajve me malësinë e Dollovishtës dhe Shishtavecit, shumë e vështirë për t'u kaluar. Në perëndim të Shkallës së Keqe lumi del në fushë të hapur dhe merr emrin Sheje duke bërë që gryka të njihej dhe si kanioni i Shejes. Ky lum derdhet në Drinin e Zi.

**Përroi i Bushtricës**- Buron nga malet e Sharrit, është i rrëmbyer. Gjatë rrjedhjes mbledh ujërat e përrënjeve të Lushit, Shkinakut, Buzëmadhës, fshatit Palush. Ky lumë përshkon fshatin e Bushtricës prandaj dhe merr emrin lumi i Bushtricës.

**Liqeni i Fierzës** i ngritur për nevoja ekonomike të kohës kur u ndërtua, vazhdon të luaj një rol të rëndësishëm dhe në ditët tona. Liqeni i Fierzës shtrihet nga Fierza në Kukës dhe futet në luginën e Drinit të Bardhë në territorin e Rrafshit të Dukagjinit. Sipërfaqja e tij është 72.5 km<sup>2</sup>, thellësi 128 m, ka formën e një shumëkëndëshi të shtrirë në zigzage në varësi të luginës së Drinit të Zi, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 11829 km<sup>2</sup> dhe lartësia e pasqyrës së liqenit 295 m mbi nivelin e detit.

**Tabelë 1.** Prurjet mesatare të periudhes ujë pak dhe muajit më të thatë të vitit

Vendmatja	F (Km2)	H (metra)	Qo, max (m <sup>3</sup> /sek)	Cv	Cs	Sigurie perqindje				
						50	75	90	95	99
Drini i Zi- Ura e Topojanit	4580	1137	24.2	0.28	0.31	23.9	19.4	15.8	13.8	9.92
Drini i Zi -Ura e Dodës	5395	1125	34.5	0.3	0.59	33.5	26.9	22.3	19.7	14.8
Drini i Zi- Kukeës	5885	1132	38.5	0.33	0.75	37	6.82	23.5	21.6	15.8
Drini I Bardhë- Kukës	4965	862	12.4	0.64	2	9.9	6.82	5.2	4.8	4.59
Drini- Kukës	10849	1009	50.5	0.36	1	47.6	37.4	29.8	26.4	21.7
Lumë- Pobreg	578	1424	2.87	0.39	0.4	2.79	2.07	1.5	1.18	0.6

**Burimi:** Akademia e Shkencave, Insituti Hidrometeorologjik

**Tabelë 2.** Parametrat e lakoreve të sigurisë dhe prurjeve maksimale me siguri të ndryshme

Vendmatja	F (Km2)	H (metra)	Qo, max (m <sup>3</sup> /sek)	Cv	Cs	Sigurie perqindje				
						1	2	5	10	20
Drini i Zi- Ura e Topojanit	4580	1137	368	0.44	1.6	925	883	710	600	480
Drini i Zi -Ura e Dodës	5395	1125	480	0.54	1.67	1370	1240	990	820	650
Drini i Zi- Kukeës	5885	1132	640	0.48	1.42	1680	1490	1240	1060	860
Drini I Bardhë- Kukës	4965	862	700	0.56	1.72	2150	1830	2670	1220	960
Drini- Kukës	10849	1009	1300	0.53	2	3750	3370	2670	2180	1720
Lumë- Pobreg			71	0.7	2.07					

**Burimi:** Akademia e Shkencave, Insituti Hidrometeorologjik

*Ka rëndësi të njihet sasia e prurjeve vjetore të lumenjëve për dy arsye kryesore:*

- **së pari**, parandalimin e fatkeqësive natyrore që mund të vijnë nga prurjet e mëdha të lumit, kur lumi del nga shtrati duke sjelle deme në ekonomi, mjedis dhe në shoqëri;
- **së dyti**, njohja e prurjeve ka rëndësi në rastin e ndërtimit të veprave ekonomike si ujësjellës, hidrocentrale, rezorvuare sepse në varësi të sasisë së prurjeve përcaktohet numri i qendrave të banuara që furnizohet me ujë të pijshëm, nëse mund të funksionojë hidrocentrali dhe në periudhat e thatësirës dhe për sa kohë mund të mbushet rezervuari etj.

Pasuria hidrike përbën një pasuri me rëndësi të madhe ekonomike. Lumenjtë tipik malorë me rrjedhje të shpejtë, ujëshumë lidhen drejtpërdrejt me ndërtimin e veprave hidroteknike që duhen për menjanimin e përmytjeve, si kanaleve ujitëse, kulluese, mbrojtësit e tokës nga erozioni etj. Këto karakteristika të lumenjve kanë favorizuar dhe ngritjen e 3 hidrocentraleve (tre mbi lumin Drin), krahas funksionit për prodhimin e energjisë, bashkë me ndërtimin e hidrocentraleve u krijua dhe liqeni artificial i Fierzës. Ky liqen ka përdorim multifunksional për ujitje e tokave bujqësore, për transportin e mallrave dhe njerëzve, sportin e peshkimit, vlera turistike dhe plazh për banorët e zonës.

Në ditët e sotme nëpo merr rëndësi lëvizja turistike për shkak të peisazhit piktoresk dhe magjepës që ofron udhëtimi nga Fierza në Koman. Kjo pasuri hidrike krijon kushte të përshtashme për zhvillimin e sektorit energjistik, po rritet numri i veprave hidroenergjitike mbi lumin Drini i Zi, në Grykën e Skavicës, janë ngritur 4 hidrocentrale të vegjël përgjatë lumit të Lumës mbi grykën e Vanave. Ndërtimi i hidrocentraleve luan rolin të madh në përdorimin në mënyrë efektive të pasurive ujore të Bashkisë Kukës, prodhimin e energjisë elektrike në mënyrë ekologjike, plotësimin e nevojave të konsumatorëve me energji.

Hidrografia mbart vlera ekonomike në ndërtimin e hidrocentraleve, prodhimi i energjisë në mënyrë ekologjike, furnizimin me ujë të qendrave të banuara, qendrave industriale, biznesit, sigurimi i ujitjes në bujqësi. Kohët e fundit po merr rëndësi zhvillimi i lëvizjeve turistike ku hidrografia do të japë kontributin kryesor nëpërmjet shijimit të ujit të burimeve të Kroit të Bardhë, Kroit të Kuq, burimit të Tanzotave, Kishëz dhe liqenin artificial të Fierzës.

Hidrografia përfaqëson mundësi për përmirësimin e jetës sociale si rezultat i shfrytëzimit të kësaj pasurie në rritje e kënaqësisë për vlerat që ka krahina e tyre, rrit dëshirën për t'i mbrojtur dhe ruajtur ato. Pasuri me vlera ekonomike, shkencore për studiuesin.

Ajo çfarë vihet re është së pavarësisht pasurisë së madhe ujore që ka Bashkia Kukës, si rezultat i keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit vihet re se kemi mungesë të ujit të pijshëm, mungesë e ujit për përdorim industrial, ndotje të tij.

Prandaj për një shfrytëzim të qëndrueshëm është përfshirja e ekonomisë së gjelbër në traditën e banorëve të krahinës duke përdorur çdo pikë të ujit që bie/ zotëron Bashkia Kukës në dy mënyrave:

1. duke mbledhur ujin e shiut, ujërat e dushit, ujërat e lavamanit, me anë të instalimit të një depozite nëntokësore, duke e filtruar më pas me anë të një pompe drejt shtëpisë dhe kopshtit
2. përdorimi i çatave të gjelbërta për të kapur ujin e shirave dhe për ta filtruar atë.

Në këtë mënyrë në kemi arritur të bëjmë një mënyrë të përdorimit të ujit sipas mënyrave të mira ekologjike dhe që ndihmojnë në realizimin e një ekonomie të qëndrueshme. Këto dy mënyra ekologjike të shfrytëzimit të ujit në Bashkinë Kukës akoma nuk është bërë realitet, por paraqitet si një mundësi e mirë për një përdorim efikas të ujit në natyrë në kushtet ku dhe efektet e ndryshimeve klimatike po ndjehen çdo ditë dhe më shumë.

Nga të dhënat hidrike të zonës së Kukësit, rrjedhjet vjetore shfaqen me cikle në vazhdimësi të ndryshme nga 2-3 vjet e deri në më tepër se 100 vjet ndryshimet e të cilës ndodhin në radhë të parë nga ndikimi i faktorëve klimatikë, kryesisht i reshjeve atmosferike dhe i temperaturës së ajrit.

Faktorët e tjerë fiziko - gjeografikë me përjashtim të rasteve të ndërhyrjeve në to të njeriut, kanë luhajtje më të ngadalshme dhe vijnë fill pas ndryshimeve klimaterike. Pa dyshim në madhësinë e koeficientit të ndryshueshmërisë së rrjedhjes vjetore, një rol të madh luan liqeni i Ohrit, sipërfaqja ujëmbledhëse e të cilit, bashkë me liqenin e Prespës, përbën rreth 50% të sipërfaqes ujëmbledhëse të Drinit të Zi.

Baseni i Liqenit të Fierzës furnizohet nga dy lumenj, Drini i Zi dhe Drini i Bardhë. Ky liqen shtrihet nga Fierza deri në Kukës, madje ai futet edhe në luginën e Drinit të Bardhë në zonën e Rrafshit të Dukagjinit.

Është e rëndësishme të theksohet se Kukësi është një territor me pasuri të mëdha hidrike. Prandaj duhen patur parasysh në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor zonat që përmblyhen ose janë në regjim kënetor.

Duke u bazuar në studimin hidrogeologjik, zonën në të cilën bën pjesë Bashkia e Kukësit e klasifikojmë në dy komplekse ujëmbajtëse. a) Kompleksi i parë që përbëhet nga shkëmbinjtë e shkrifët (poroz) ose Kompleksi kuaternar (a) Me ujëmbajtje të lartë alQh2, i cili shtrihet në zonën buzë lumit Lumes. Në bazë të studimeve të kryera si dhe regjistrimet e bëra nga skarpatet artificiale të hapura për rrugën Durrës-Morinë. Kështu periudha deri në vitin 1960 ka qënë në përgjithësi me më pak ujë se periudha në vijim të saj ku prurjet kapin një mesatare prej 300 m<sup>3</sup> në sekondë. Lumi Lumës përfaqësohet nga zhavorr e zhurë ujëmbajtëse me trashësi 2 deri në 5 metra dhe (b) me ujëmbajtje mesatare deri të ulët. Ujëmbajtja është e vogël, nga 0.06 – 1.21 l/sek. por takohen edhe dy burime me debit të madh. I pari ndodhet në fshatin Kënetë dhe përfaqëson një grup burimesh që dalin në një zonë moçalore me debit të përgjithshëm 20-30 l/sek ndërsa burimi i dytë del në fshatin Bushat dhe ka një debit 3 l/sek. Të dyja burimet kanë ushqim anësor dhe nga gëlqerorët e Triasikut të sipërm dhe kanë një kuotë respektive absolute 275 dhe 325 metra dhe (c) Me ujëmbajtje të ulët (N2-Qp) i) Kompleksi i dytë që përbëhet nga shkëmbinjtë kompakt: (a) me ujëmbajtje të lartë ku janë monitoruar dy burime të fuqishme ujore, ai i Gurrës dhe i Kolosjanit, si dhe burimi i Lomjes.; (b) Me ujëmbajtje mesatare deri të ulët dhe (c) me ujëmbajtje të ulët.

### **3.1.1 Ujësjellës-Kanalizime Ndërmarrja e ujësjellës-kanalizime Kukës**

Ndërmarrja ka formën ligjore Shoqëri Anonime dhe i shërben qytetit të Kukësit dhe dy njërive administrative Shtiqen dhe Bicaj. Ajo i shërben një popullsie rreth 40,000 banorë me një orar mesatar furnizimi me ujë prej 9 orësh në ditë dhe një cilësi uji brenda normave. Shërbimi i jepet 25,000 banorëve që jetojnë në qytet dhe 15,000 banorëve që jetojnë në fshatra. Sipas të dhënave për Kukësin, 39,600 banorë e marrin shërbimin në shtëpi, ndërsa 400 të tjerë në cezma publike. Ndërsa shërbimi i sistemit të ujërave të zeza i ofrohet banorëve të qytetit 100% ndërsa u ofrohet banorëve të disa fshatrave tdisa fshatrave të njësisë administrativeve Bicaj .

Prodhimi i ujit është me rënie të lirë gjë që lehtëson kostot operative të ndërmarrjes. Gjatësia totale e sistemit të ujësjellësit është 115.6 km të cilat ndahen në 25.1 km tubacionet e rrjetit kryesor dhe 90.5 rrjeti dytësor ose shpërndarës. Sistemi kryesor dhe dytësor i tubacioneve përbëhet nga materiale të ndryshme ku 0.18 % e zënë tubacionet prej çeliku. Niveli i faturimit të ujësjellësit nuk realizohet 100%. 17.5% e ujit është i pafaturuar. Kjo diferencë vjen për shkak të dëmtimeve të rrjetit dhe çarjeve të tubacioneve të cilat janë në një nivel shumë të lartë – 2681 çarje në total. Pjesa më e madhe janë klientët pa matësa 61% ndërsa sipas vendodhjes (qytet ose fshat) klientët e qytetit zënë 69% të totalit. Mbetet problem zonat informale dhe të drejtat e pronësisë mbi kanalizimet dhe tubacionet e ujësjellësit. Kjo

çështje do të jetë një nga prioritetet e Bashkisë në të ardhmen me qëllim që të realizohet një hartë e qartë e shërbimeve për të gjithë zonën, përfshirë edhe zonat informale. Gjatësia totale e sistemit KUZ-së në qytet është 32 km dhe e gjitha është material prej betoni. Numri total i lidhjeve me sistemin është 3,434. Vëllimi total i ujit që faturohet për KUZ është 459.9 mijë m<sup>3</sup>. Vetëm 60.4% e shërbimit arrin të faturohet, ndërsa norma mesatare e arkëtimit është 55,3%. Ndërsa në njësitë e tjera administrative shërbimi i ujësjellësit ofrohet nga vetë njësitë administrative (Shishtavec, Terthore, Kolsh, Malzi, Topojan, Ujmisht, Grykë-Cajë, Arren, Surroj). Furnizimi i banorëve me ujë në disa fshatra bëhet përmes çezmave publike gjë që e bën mjaft të vështirë situatën e banorëve. Përmirësimi i situatës së ujësjellës-kanalizimeve kërkon marrjen e një sërë masash për përmirësimin e shërbimit, të tilla si: (i) riorganizimi i prodhimit e trajtimi i ujit; (ii) përmirësimi i menaxhimit dhe rrjedhimisht një shërbim më të mirë dhe efikas banorëve; (iii) forcimi i kontrollit sanitar dhe krijimi i sistemeve të nevojshëm për klorifikim dhe disinfektim të ujit sipas standarteve; (iv) rritja e nivelit të faturimit nëpërmjet gjetjes së mënyrës më efikase për vjeljen e faturave; (v) përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet rritjes së investimeve publike; (vi) rritjen mbulimit të zonës me infrastrukturën dhe shërbimet e kanalizime të ujërave të zeza; të drejtat e pronësisë dhe vlerësimi i saktë i inventarit të aseteve të Bashkisë.

### **Sistemi Ujor**

Sistemi ujor (U) është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë”. Procesi i planifikimit dhe zhvillimit në terriore, që i përkasin kategorisë bazë të përdorimit “Ujëra dhe ligatina” rregullohet sipas legjislacionit të posaçëm dhe konventave ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Shqipëria. Çdo zhvillim në brigjet ujore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm.

Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit ujor;
- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Ndërtimi i veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e rezervave ujore dhe për parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit janë objekt i lejeve administrative ose koncesioneve, kur këto janë brenda kuadrin të shërbimeve publike. Është i ndaluar magazinimi i materialeve dhe lëndëve, që mund të shpëlahen në ujë dhe ndërtimi i objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmytjet. Menaxhimi shkencor i ujit dhe energjisë ka qenë dhe mbetet një target thelbësor me pasoja të rëndësishme për të sotmen dhe mirëqenien e brezave të ardhshëm. Bashkimi Evropian ngulmon, që rritja ekonomike nuk duhet të kondicionohet me përdorimin intensiv të burimeve në përgjithësi e sidomos të atyre ujore e energjetike në veçanti. Kjo duhet të kompensohet me zhvillimet në teknologji efektive për ruajtjen e bilanceve të përdorimeve të tyre me kërkesat në rritje të nevojave jetike për to: të ruajtjes dhe të rigjenerimit të tyre. Raportet aktuale midis rritjes ekonomike, konsumimit të resurseve ujore e energjetike dhe prodhimit të mbetjeve të ndryshojnë në mënyrë thelbësore. Zhvillimi ekonomik duhet të shoqërohet me përdorimin racional e të qëndrueshëm të burimeve të ujit dhe energjisë, me prodhimin e sasive të kufizuara të mbetjeve, duke ruajtur biodiversitetin, ekosistemet dhe mënjeluar transformimin e mjedisit në djerrinë.

Bashkia Kukës zotëron burime të mëdha hidrike. Në territorin e saj kalon lumi Drin me dy degët e tij, me një sipërfaqe ujëmbledhëse totale prej 25022 km<sup>2</sup> dhe baseni i Liqenit të Fierzës me sipërfaqe 72.5 km<sup>2</sup>. Me rëndësi është të nënvizohen se këto burime përfshihen në burimet natyrore të ripërtëritshme



dhe janë pjesë e rëndësishme e sektorit të energjisë kombëtare, që mbështetet rreth 99% në burimet hidrike. Si të tilla janë ndoshta pasuria natyrore më e madhe dhe më e rëndësishme e vendit, kjo për shkak të një cilësie të veçantë që nuk e zotëron as edhe një pasuri tjetër. Ato janë të pashtershme dhe të rinovueshme.

Qarku i Kukësit është një nga zonat më të pasura me burime ujërash sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në Shqipëri. Rrjeti ujqor është i dendur dhe, i përbërë nga lumenj, përrenj, burime, ujmbledhës dhe liqene natyrore. Rrethin e Kukësit e përshkojnë lumenj, përrenj ku më të rëndësishmit janë i Drini i Bardhë, Drini i Zi, Lumi i Lumës, Përroi i Orgjostit, Bushticës, Shejës, Tershenës, dhe Leshnicës.

Ne Bashkinë e Kukësit burimet ujore gjejnë përdorim në sektor të ndryshëm të ekonomisë. Sasitë më të mëdha përdoren në energjetike. Konsumatori më i madh është Hidrocentrali i Fierzes. Janë ngritur edhe disa hidrocentrale të vegjël lokale, në rrethin e Kukësit. Sasi të konsiderueshme përdoren për nevojat e bujqësisë, industrisë dhe ujë të pijshëm për popullatën.

Rritja e numrit të popullsisë në zonat urbane ka sjellë rritjen gjithnjë e më shumë të kërkesave për ujë të pijshëm. Furnizimi i popullatës në këto zona behet nëpërmjet ujësjellësve, ndërsa në shumicën e fshatrave furnizimi bëhet nga burimet dhe pusët. Në asnjë qytet apo qendër banimi të qarkut Kukës nuk sigurohet ujë i pijshëm për 24 orë pa ndërprerje

**Në rrethin e Kukësit** nën administrim e Ndërmarrjes së Ujesjellësit janë tre ujësjellës me anë të cilëve bëhet furnizimi me ujë të pijshëm i rreth 40 mijë banorëve të qytetit e të 12 fshatrave, si Kolesjan, Domaj, Gabrriçe, Mhole, Osmane, Cane, Bushat, Nange, Brate, Shtiqen dhe Koder-Lume.

Tre burimet e furnizimit janë:

- a. Burimi Domaj me prurje 55 - 100 l/sek.
- b. Burimi Kolesjan me prurje 12 - 25 l/sek.
- c. Burimi Lojme me prurje 10 - 20 l/sek.

Teknologjia e përdorur për grumbullimin e shpërndarjen është ajo me rrjedhje të lirë. Në rezervuarët e depozitimit bëhet klorinimi ritmikisht e i kontrolluar. Treguesit cilësorë kanë qenë brenda standarteve të kerkuara, kjo e vertetuar edhe me analizat kimiko-fizike e bakterologjike të bera nga Inspektorati Higjieno-sanitar. Gjendja teknike e rrjetit shpërndarës veçanerisht në qytet le për të dëshiruar, pasi në shume segmente kërkohet nderhyrje për rikonstruksion, si rezultat i amortizimit.

Sasia vjetore e furnizimit me ujë ka qenë si me poshte:

- a. për popullatën 1200000 m<sup>3</sup>
- b. për nevoja publike 350000 m<sup>3</sup>
- c. për nevoja teknologjike e sektorin privat 110000 m<sup>3</sup>

Nuk është siguruar furnizim 24 orësh pa ndërprerje. Kohezgjatja e furnizimit është: për periudhën e verës 6 - 8 orë në 24 orë me një sasi 100 l për banorë; për periudhën pranverë - vjeshtë 10 -14 orë në 24 orë me një sasi 150 l për banorë.; për periudhën e dimrit 20 orë në 24 orë me një sasi 200 l për banorë.

Me ujësjellës furnizohen edhe disa fshatra si Shikaj, Dukagjin, Qinamake, Novosej etj. Këto janë ujësjellës të vegjël me vetërrjedhje dhe administrohen nga Njësia Administrative. Administrimi i tyre le mjaft për të dëshiruar , pasi në shume raste nuk bëhet klorinimi dhe uji rezulton të jetë i ndotur me ngarkesë bakteriale.

Burimet ujore te ujit te pijshem ne qarkun e Kukësit janë përgjithesisht burime me ujë cilësor sa i perket karakteristikave fiziko-kimike ashtu edhe përta i përket ngarkesës bakteriale. Prishja e këtyre karakteristikave behet gjate grumbullimit e shperndarjes ne rrjet.

**Ne rrethin e Kukësit** nga matjet e bera ne mostrat e marra ne vendburimet e ujesjellesve te qytetit, te disa fshatrave si dhe ne rrjetin shperndares te tyre rezulton se, per treguesit kimiko fizike cilesia e ujrave eshte brenda standarteve te kerkuara.

### **3.1.2 Cilesia e Ujrave Sipërfaqësore**

Nga vezhgitmet tona empirike, mbasi ne qarkun e kukesit muk ka asnje institucion per te bere monitorimin e cilesise se ujrave, mund te themi se problemi me i madh ehte ndotja e ujrave te basenit te liqenit te Fierzes. Burimet e ndotjes te ketyre ujrave jane:

Materialet inerte (kryesisht materiale plastike, si shishe bidona shiringa etj) qe grumbullohen dhe e ndotin kete basen nga prurjet e lumenjve Drini i Bardhe, Drini i Zi, dhe lumi Luma. Duke qene se keta lumenj kalojne neper nje territor te gjere edhe jashte kufijve shteterore (si Kosove e Maqedoni) dhe brigjeve te ketyre lumunjve behet depozitimi i mbetjeve urbane ndodh ndotja masive me keto materiale. Kjo ndotje ka qene mjaft shqetesuese keto vitet e fundit. Ky problem eshte kompleks mbasi perfshin edhe terriore jashte kufijve shteterore.

Ritja e popullsisë në qendrat e banuara shtimi i aktiviteteve industriale dhe veprimtarive të tjera është shoqëruar me rritjen e kërkesës për përdorimin e ujit por njëkohëshit edhe me rritjen e efekteve të ndotjes. Në qarkun e kukësit sasia e përdorimit të ujit ka pësuar rritje të ndjeshme në sektorin e energjetikës, bujqësisë dhe shërbimeve hoteliere. Vetëm në 3-4 vitet e fundit janë ndërtuar 5 hidrocentrale, 4 në rrjedhën e lumit Luma një në rrjedhën e lumit të Çajës.

Numri i ujmbledhësve në të gjithë Bashkine është 5. Kapaciteti i përgjithshëm volumor kalon 1 milion m<sup>3</sup> ujë. Rezervuarët janë të shtrirë në një sipërfaqe mbi 5 km<sup>2</sup>.

Ujrat nëntokësorë kanë qenë dhe mbeten një pasuri e madhe që janë shfrytëzuar e shfrytëzohen nga veprimtaritë njerzore në qarkun e kukësit. Kryesisht ato përdoren si burime për ujë të pijshëm ose përdorim ujitje e familjar.

E gjithë kjo sasi uji që përdoret ka ndikimet e të drejtpërdrejta në cilësinë e mjedisive ujore duke ndikur në ndryshimin e vetive natyrore.

Burimet kryesore të ndotjes së ujrave sipërfaqësor në qarkun e kukësit janë mbetjet urbane shkarkimet e lëngëta (ujrat e zeza), dhe ndotjet nga aktiviteti i industrisë minerare.

### **3.1.3 Ujrat Nëntokësorë**

Megjithëse monitorimet e kryera nga shërbimi gjeologjik shqiptar i përkasin rrjedhës së poshtme të basenit të drinit ne po i pasqyrojmë ato në këtë analizë mbasi lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me të gjithë basenin e Drinit. Mundësia më e madhe e ndotjes së UN është gjithnjë në rrjedhat e poshtme dhe në zona me aktivitet të lartë njerzor.

Monitorimi synon ruajtjen e rezervave të shfrytëzimit, mbrojtjen e vendburimeve egzistuese të ujit, si dhe për të vlerësuar shkaqet e ndotjes së ujrave nëntokësore. Në përfundim të monitorimit jepen rekomandimet për zbatimin e zonave të rreptësisë dhe të mbrojtjes sanitare.

Monitorimi i ndotjes së ujrave nëntokësore ka siguruar vijueshmërinë nga viti 2000 - 2020 në akuiferët e depozitimeve zhavorore më kryesore të Kuaternarit në 7 basene ujëmbajtëse. Vlerësimi dhe zbatimi i

monitorimit të UN është vleresim dhe mbrojtje për pasurinë më të madhe kombëtare -UJIN- duke e bërë monitorimin një disiplinë të re dhe shkencore që garanton:

- Ruajtjen e rezervave të shfrytëzimit të UN
- Mbrojtjen e vendburimeve ekzistuese të uji
- Vlerëson shkaqet e ndotjes së UN
- Jep rekomandime për zbatimin e zonave të rreptësise dhe mbrojtjes sanitare e në bashkëpunim me organet kompetente të marrë masa ndëshkuese për këto probleme.

### **Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca.**

Në zonën funksionale të Kukësit ndërmarrja e ujësjellës kanalizime Kukës. ka një staf prej 70 punonjësish që i shërben një popullsie rreth 40,000 banorë me një orar mesatar prej 9 orësh në ditë dhe një cilësi uji brenda normave. Cilësia e ujit në komuna është e mirë dhe nuk janë raportuar raste sëmundjesh për shkak të ujit, megjithëse është zonë me potenciale minerare. Prodhimi i ujit është me rënie të lirë gjë që lehtëson kostot operative të ndërmarrjes. Gjatësia totale e sistemit të ujësjellësit është 115.6 km. Në komuna shërbimi i ujësjellësit është komunal (Shishtavec, Terthore, Kolsh, Malzi, Topojan, Ujmisht, Grykë-Cajë, Arren, Surroj). Furnizimi i banorëve me ujë në disa fshatra bëhet përmes cezmave publike gjë që e bën mjaft të vështirë situatën e banorëve në komuna. Problematike mbetet arketimi i faturave në komuna për arësye të gjendjes ekonomike të popullsisë. Kemi një diferencë prej 17.5% të shërbimit të pafaturuar, e cila shkaktohet për shkak të dëmtimeve të rrjetit dhe carjeve të tubacioneve të cilat janë në një nivel shumë të lartë. Pergjithesisht ne Njesite Administrative nuk merret tarifë për ujin pasi gati të gjithë ujësjellësit në këto NJA janë me rrjedhje të lirë e rrjedhimisht nuk kanë kosto energjie elektrike. Në zonë ka problematika që kanë të bëjnë me zonat informale dhe të drejtat e pronësisë mbi kanalizimet dhe tubacionet e ujësjellësit.

### **Gjendja e cilësisë së ujrave sipërfaqësorë të Bashkisë Kukës**

Monitorimi i ujrave sipërfaqësor në Bashkinë e Kukësit është një ndër objektivat e Axhencise Rajonale të Mjedisit. Për monitorimin, krahas vrojtimit të vazhdueshme vizuale është bashkëpunuar edhe me Sektorin e monitorimit pranë AKM-së si dhe me Departamentin e Biologjisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Ujërat e Fierzës mbledhin gjithë ndotjen urbane që vjen nga gjithë këto zona të banuara brenda këtij pellgu të gjerë, të cilat shkarkohen të patrajtuara në ujëra. Të gjitha këto shtojnë përmbajtjen e lëndëve ushqyese (azot dhe fosfor) edhe pse të dhënat për këto mungojnë.

Ndotjet e liqenit të Fierzës nga mbetjet urbane janë të përvitshme. Nga vrojtimit e bëra rezultoi se mundësia më e madhe ndotjes është periudha Prill-maj. Në këtë periudhë rritet niveli i ujrave të basenit si rezultat i reshjeve dhe shkrirjes së borës. Mbetjet e depozituara në brigjet e rrjedhave ujore barten dhe depozitohen në liqe, duke krijuar ndotje në sasi të madhe me mbetje inerte. Kjo ndotje në përqindjen më të madhe është e përbërë nga materialet plastike (shishe, kuti, ambalazhe të ndryshme.)

Periudha e dytë është shtator –tetor . Në këtë periudhë bie niveli i ujrave dhe mbetjet ngelen brigjeve duke krijuar “ kordone” me mbetje inerte. Të cilat me rritjen e nivelit të ujrave pluskojnë në sipërfaqe duke krijuar një pejsazh të pakëndshëm dhe shqetësues.

Për vitin 2021 u organizuan disa aksione vullnetare për pastrimin e mbetjeve tërheqjen e transportimin e tyre në impiantet e riciklimit. Në këto aksione u përfshinë institucionet shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore, nxënësit e shkollave dhe ushtria. Sasia e këtyre mbetjeve ishte mbi 280m<sup>3</sup>.

Problemi i ndotjes së ujrave të liqenit është kompleks. Ai është jo vetëm problem lokal por edhe ndërkuftarë dhe kërkon një angazhim të institucioneve përgjegjëse, respektive edhe në Kosovë e Maqedoni për ngritjen e një grupi të përbashkët specialistësh për të analizuar të gjitha çështjet dhe mbi bazën e kësaj analize hartimin e një strategjie dhe plani veprimi për vënien nën kontroll të situatës.

### **Analiza e fitoplanktonit**

Krahas ndotjes nga mbetjet urbane prej disa vitesh vihet re edhe lulëzimi i algave blu-të gjelbërta. Për këtë dukuri nuk ishte bërë asnjëherë monitorim.

Ndër 5'000 llojet e fitoplanktonike ekzistuese, rreth 300 lloje mund të rriten vullshëm, në sasi mbi 1 milion qeliza për litër, dukuri e njohur si lulëzim algash (algal blooms). Këto mund të ngjyrosin ujin (red tides), ndërsa rreth 100 lloje mund të prodhojnë helme shpesh të fuqishme (Harmful Algal Blooms, HAB) (Hallegraeff et al., 2003). Lulëzimet e algave janë sot të pranishme në shumë trupa ujorë në mbarë botën, shpesh me pasojë të rënda për botën e gjallë ujore dhe për vetë shëndetin e njeriut.

Komunitetet e fitoplanktonit në verë në ekosistemet eutrofë me ujë të ëmbël si rregull mbizotërohen nga cianobakteret, të quajtura gjithashtu edhe alga blu- të gjelbra. Kjo dukuri është sot çështje e rëndësishme kërkimore e limnologjisë, dhe sfidë e menaxhimit të liqeneve të temperuar në mbarë botën (Yamamoto & Nakahara, 2009; Bellinger & Sigeo,.). Studimet kanë zbuluar se kushte të veçanta mjedisore, si përqendrimet e ulëta të CO<sub>2</sub> dhe raport i ulët azot : fosfor, shoqërohen me lulëzime të shumë cianobaktereve, kryesisht të gjinive *Microcystis* dhe *Anabaena*.

Këtu përshkruhet për herë të parë për ujërat e ëmbla shqiptare shfaqja e një lulëzimi cianobakteresh, kjo në liqenin e Fierzës, Kukës. Për më tepër, jepen të dhëna të tjera me karakter njohës dhe ndërgjegjësues mbi këtë dukuri.

Vlen të theksohet se cilësia biologjike e ujërave sipërfaqësore të bashkisë Kukës është përgjithësisht e 'mirë' ose 'shumë mirë', sidomos në gjithë zonat e thella malore të vendit, ku prania dhe ndikimi ndotës i njeriut është i ulët.

Lulëzimi i cianobaktereve vrojtuar në Liqenin e Fierzës është deri sot rasti i parë për ujërat e ëmbla të qeta. Kjo dukuri duhet të vlejë si sinjal fillestar për njohjen dhe ndërgjegjësimin për të bashkuar përpjekjet për të ruajtur cilësinë dhe gjendjen e ujërave tona, dhe për të parandaluar përhapjen e lulëzimeve dhe gjithë ndikimet e dëmshme që ato shpesh i shoqërojnë. Gjithmonë në këto raste këshillohet trajtimi i ujërave të shkarkimit dhe përkujdesje në pellgjet ujëmbledhës, si luftë ndaj erozionit (përdorim me kujdes i tokës, shtim i mbulesës bimore, pyllëzim i vazhdueshëm etj.), në rastin konkret edhe në Kosovë.

Shumë e rëndësishme është njohja e potencialit ujor të rrjetit hidrografik të bashkisë , që do të përfshijë elemente të tillë të rëndësishëm të natyrës së zonës si, burimet, liqenet, lumenjtë, ujërat nëntokësore, si dhe hapësirën e rëndësishme që zë liqeni artificial

- Prioritet maksimal për menaxhimin e burimeve ujore rekomandohet mbrojtja e burimeve hidrike të zonës.
- Përcaktimin e vijës blu, të mbrojtjes së sipërfaqeve hidrike dhe fashat mbrojtëse të kërkuara nga kuadri ligjor.
- Përcaktimi i fashës së mbrojtës së lumenjve nga burimet potenciale të demtimit dhe ndotjes,
- Evidentimi i zonave të rrezikshme për njeriun si rezultat i përmbytjeve, ose që janë në rrëgjim kënetor.
- Evidentimi i zonave të ndotura nga aktiviteti njerëzor dhe përcaktimi i afateve kohore për mundësinë e rigjenerimit të tyre.

- Përcaktimi i zonave të përshtatshme për zhvillim turistik ujqor.
- Përcaktimi i zonave me prioritet zhvillimin e peshkimit dhe infrastrukturës së nevojshme.


Bashkitë duhet gjithashtu të jenë përgjegjëse për detyrat tjera specifike të identifikuar me Ligj, si: Ndërtimi i objekteve për ujërat (neni 40), Mbrojtja nga vërshimet (neni 46), Mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujit (neni 47), Mbrojtja e shtratit të ujërave (neni 49), Mbrojtja nga erozionit (neni 51), Rregullimi i lumenjëve, përrenjëve dhe krojeve (neni 55), Njoftimi Ministrisë në rast të rrezikut nga uji (neni 57), Përcaktimi i zonave për larje (neni 68), dhe Lëshimi i lejeve të ujit (neni 72).<sup>12</sup>

Bashkitë gjithashtu kanë përgjegjësi për aktivitetet inspektuese nga inspektorët mjedisor, që zakonisht punësohen në kuadër të Departamentit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mjedis (DPUKM) apo në kuadër të Departamentit për Inspektim (DI), në përputhje me organizimin e brendshëm të miratuar nga secila komunë.

Një tjetër plan që ndihmon në mënyrë të tërthortë në menaxhimin e ujit, është plani i menaxhimit të integruar të mbetjeve (PMIM), Bashkia Kukës. PMIM ofron zgjidhje lokale gjerësisht të pranuar dhe një kuadër të miratuar pune, sipas të cilit mund të merren vendime lidhur me infrastrukturën që nevojitet, për të përmbushur zbatimin e praktikave më të mira mjedisore.

### 3.2 Struktura organizative e menaxhimit të ujërave në Bashkinë e Kukësit

Menaxhimi i ujit në Bashkinë Kukës realizohet sipas legjislacionit, aktet ligjore në fuqi dhe në bashkëpunim me strukturat e linjës. Ky process është ilustruar dhe me organigramën.



**Figurë 2.** Institucionet për shërbimin Ujësjetës- Kanalizimeve, Bashkia Kukës **Burimi:** ACER, bazuar në strategjinë e Ujësjetës- Kanalizime, 2020-2030

Bashkia Kukës për menaxhimin e burimeve ujore është në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe Bashkitë.<sup>13</sup>

Bashkëpunimi midis bashkisë dhe MIE, realizohet ndëpërmjet marreveshjeve për shërbimet e ujësjetës-kanalizimeve. Bashkia duhet të mbajnë inventarin e infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, të transferuar në pronësi të tyre.

**Bashkia** nëpërmjet strukturave të saj bën të mundur:

<sup>13</sup> Shih kuadrin ligjor, niveli qendror, fq.5

Shfrytëzimin, rehabilitimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi;

Mbikëqyrjen e sigurisë së digave të rezervuarëve për ujitje;

Monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujit që përdoret gjatë një viti;

Caktimin dhe mbledhjen e tarifës vjetore të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe shërbimit të ujitjes për çdo sipërfaqe toke, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes<sup>14</sup>.

**Asambleja e Përgjithshme** përfaqësohet nga kryetari i bashkisë përkatëse, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

**Këshilli i Administrimit** është organi i vetëm që ushtron funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje të veprimitarisë së shoqërisë.

**Qëllimi kryesor i Ujesjellës s Kanalizime Kukes sh.a** është shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij.

Shërbime të tjera që ofron kjo shoqëri janë:

Mirëmbajtja e sistemit/eve të furnizimit me ujë të pijshëm.

Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve.

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, shitja e tij.

Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre<sup>15</sup>.

### 3.3 Analiza e treguesëve të performancës së shoqërisë UK Kukës

Enti Rregullator i Ujit monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e sektorit UK në tërësi dhe secilit operator në veçanti për shërbimet e furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2020. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur krahasimi i treguesve të performancës së sektorit me treguesit e UK Kukës.

**Tabelë 3.** Krahasimi i treguesve të performancës të sektorit të UK (%) për vitet 2019, 2020

Nr	Treguesit e Performancës	2019	Viti 2020		Vlerësimi
		UK Kukës	UK Kukës	Gjendja e sektorit	
1	Uji Pa të Ardhura (Humbjet)	21	35	65.1	+
2	Norma e Arkëtimit Korrente	49	35	76.8	-
3	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	80	63	89.9	-
4	Niveli i Matjes	35	37	79.4	-
5	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (ore/ditë)	24	8.4	13.79	-

<sup>14</sup> Porta Vendore.al, Sistemet e Ujitjes & Kullimit [\[link\]](#)

<sup>15</sup> Shoqëria UK Kukës, faqe online [\[link\]](#)

6	Mbulimi me ujësjellës	75	75	75.8	=
7	Mbulimi me Kanalizime	42	40	50.8	-

**Burimi:** ERRU, Raporti Vjetor 2019 [\[link\]](#), 2020 [\[link\]](#)

**Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2020** krahasuar më atë të vitit 2019 paraqitet në një përkeqësim në drejtim të treguesve si: *niveli i matjes, norma e arkëtimit, kohë zgjatja e furnizimit*. Treguesit e tjerë paraqiten në vlera të qëndrueshme.

Analiza e treguesëve kryesorë të performancës ka rëndësi për shkak të ndërvarësi nga njëri-tjetri dhe ndikimi pozitiv apo negativ i secilit tregues reflektohet dhe në treguesit e tjerë. Kjo sjellë përkeqësimin në grup të pothuaj të të gjithë treguesve të performancës. Më poshtë jepet me detaje analiza e ecurisë për secilin tregues kryesor të performancës për UK Kukës.

**"Uji Pa të Ardhura"**, është një nga tregues i rëndësishëm. UK Kukës ka nivel të mirë të këtij treguesi krahasuar me vlerën në nivel sektori. Krahasuar me vitin 2019, ky tregues paraqet rritje nga 21% në 31%. Por niveli i këtij treguesi ndikohet nga treguesi **"Niveli i Matjes"**. Ky tregues paraqitet në nivel të ulët për rastin e Bashkisë Kukës krahasuar me sektorin. Kjo dëshmon dhe për një nivel të lartë të humbjeve në rrjet. Kjo situatë mund ta shpjegohet nga mungesa e matësve të prodhimit dhe konsumit të ujit.

**"Norma e Arkëtimit"** lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. Në vitin 2019, ky tregues ishte 80%, ndëkohë për vitin 2020 vlera e tij është raportuar 63%. Faktor që mund të kenë ndikuar në ecurinë e këtij treguesi janë: pandemia e Covid-19, humbja e vendeve të punës ( brenda dhe jashtë kufirit) dhe thellimi i varfërisë.

**"Mbulimi me Kanalizime"** është pothuajse konstant me nivelin e sektorit. Ky shërbim ofrohet nga bashkia Kukës.

**"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë"** lidhet direkt me cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë që furnizohen konsumatorët. Ky tregues për vitin 2020 ka një tendencë renëse krahasuar me vitin 2019. Kjo lidhet me mungesën e menaxhimit të lidhjeve të paligjshme të ujit, uljen e prurjeve nga burimet dhe mungesa e reshjeve të shiut ( këto të fundit pasojë të ndryshimeve klimatike).

#### 4. Problematikat kryesore në lidhje me menaxhimin e ujit në Shqipëri

Duke u bazuar në Kuadrin e OECD për Menaxhimin Ujërave (OECD, 2015<sup>16</sup> në këtë seksion do të analizohen problematikat kryesore në lidhje me menaxhimin e ujit në Shqipëri.

##### 4.1 Mangësitë institucionale

Parimet e OECD-s për Menaxhimin Ujërave kërkojnë krijimin e një kuadri të qartë institucional, i cili përcakton mirë dhe ndan përgjegjësitë dhe rolet për hartimin e zbatimin e politikave për ujin, veprimtaritë operationale dhe rregullatore, ndërkohë që nxit bashkërendimin ndërmjet autoriteteve përgjegjëse.

Nga pikëpamja institucionale, menaxhimi i burimeve ujore në Shqipëri:

<sup>16</sup> Parimet e OECD-s për Menaxhimin Ujërave (2015) [\[link\]](#) shiko [Aneks 1](#).

- është pothuajse i centralizuar.
- Ndryshime e shpeshta, kanë çuar në mbivendosjen e përgjegjësive ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe atij vendor, gjë që ka rezultuar në një sektor ujqor të fragmentuar, me veprimtari joefikase dhe mungesë transparence.
- numërohen rreth 50 autoritete të ndryshme, organizata dhe grupe të angazhuara në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve ujore, ku 20 prej tyre janë institucione të ndryshme qeveritare që monitorojnë e burimeve ujore.

Nga kjo situatë, vendimet në lidhje me investimet nuk janë marr duke u patur parasysh nevojat e sektorit duke çuar në *mundësi të humbura dhe shpenzimet të tepërta të financave publike*.

Rolet në sektorin e burimeve ujore janë shpërndarë në institucione të shumta.

Çështjet për menaxhimin e burimeve miratohen sipas një hirarkie të mirë përcaktuar nga nivel qendror deri në atë vendor, bashkëpunimi midis hallkave ndërmjetësve ka çuar në një mungesë kapaciteti në nivel baseni e cila është shkalla e duhur për menaxhimin e ujit.

Në Strategjinë MIBU citohet që: *“Menaxhimi i burimeve ujore në shkallë të përshtatshme brenda sistemeve të menaxhimit të integruar të basenit me qëllim reflektimin e kushteve lokale dhe bashkërendimin ndërmjet niveleve të ndryshme duke u bazuar në një menaxhim të mirëtë ciklit hidrologjik”*

Në këtë kuadër duhet që funksionimi i Këshillave të Baseneve Ujore në Shqipëri në nivel rajonal të zhvillojnë kapaciteteve teknike dhe administrative.

#### **4.2 Mangësitë e të dhënave dhe informacionit**

Për hartimin e politikave në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore, duke u bazuar edhe në parimet e OECD, të dhënave dhe informacionet përkatëse për ujin duhet të jenë konsistente, të krahasueshme dhe të shkëmbyeshme.

Kjo kërkon bashkëpunim efikas për shkëmbimin e informacionit ndërmjet prodhuesve, mbledhësve të të dhënave dhe përdoruesve të tyre, që kanë lidhje me ujin. Monitorimi mjedisor nuk është i mjaftueshëm, duke që në nuk mundëson zbatimin e metodave të reja vlerësuese. Kjo kërkon përmirësimin e kapaciteteve monitoruese, raportuese dhe vlerësuese nga ana institucioneve që merren me menaxhimin e ujit. Mangësia kryesore e mbledhjes së informacioni është mos ekzistenca e metodave për shkëmbimin e të dhënave për ujin.

#### **4.3 Mangësitë financiare**

Duke u bazuar në Parimet e BE-së për politikën e mjedisit, siç janë parimet “ndotësi paguan” dhe “përdoruesi paguan”, si dhe pagesa për shërbimet mjedisore. Pagesat për shërbimet mjedisore janë përfshirë edhe në rregulloret e institucioneve në Shqipëri. Një tjetër problem është analiza dhe vlerësimi i kostove për zbatimin e investimeve të mëdha të Direktivave të BE-së, që kanë në fokus trajtimin e ujërave të ndotura urbane, ofrimin e ujit të pijshëm dhe menaxhimin e rreziqeve të përmytjeve. Krijimi i një sistemi tarifash administrative efektive dhe të barabarta do të sigurojë se mangësia e financimit të ulet efektivisht në nivel të Basenit Ujqor.

#### **4.4 Mangësitë ligjore**

Ligji Nr. 111/2012 është një bazë e rëndësishëm për menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri. Ligji Nr. 111/2012 është një akt kuadër tipik me dispozita për çështje të ndryshme që duhet të bëhen nëpërmjet akteve nënligjore (VKM), gjithsesi sistemit Shqiptar i mungon legjislacioni përkatës dytësor,



përsa i përket mekanizmave që duhet të përdoren me qëllim ofrimin e një sektori efektiv dhe të integruar të ujit.

#### **4.5 Mangësitë në kapacitete**

Mangësitë në kapacitete janë kryesisht administrative dhe lidhen me detyrat e Agjensisë së Baseneve Ujore që lidhen me zbatimin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Këto çështje kanë të bëjnë përdorimi i ujit; kontrollin dhe monitorimin e e ndotjes; planifikimin e basenit ujor; pjesëmarrja e palëve të interesit; menaxhim ekonomik dhe financiar; menaxhimin e informacionit.

#### **4.6 Mangësitë në angazhimin e grupeve të interesit**

Angazhimi grupeve të interesit në lidhje me hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore nuk është i vazhdueshëm. Duhet që këto grupe të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet dhe kostot që lidhen me disponueshmërinë e ujit, që të ndikojë për një qëndrueshmëri të burimeve ujore dhe përballim të sfidave në të ardhmen. Projektet për zhvillimin e infrastrukturës duhet të jenë gjithëpërfshirës të grupeve të interesit në diskutime dhe në zbatimin e tyre me qëllim shmangien e përkeqësimit problemet ekzistuese me ujin në Bashkinë Kukës. Ndërgjegjësimi publik, përfshirja e shkollës si dhe edukimi dhe aktivitetet e vazhdueshme dhe praktike janë jetike për të qenë të aftë të krijojmë një debat të sinqertë dhe të informuar.

#### **4.7 Problemetikat kryesore të sektorit të Ujësjellës-Kanalizime në Bashkinën Kukës**

- Mungesa e matësave të prodhimit dhe konsumit;
- Rrjeti i shpërndarjes mjaft i amortizuar;
- Vazhdojnë të jenë evidente Lidhjet e paligjshme dhe mosfaturim i të gjithë klientëve;
- Mosfunksionimi i duhur i mekanizmave të rregullimit Liçenca – Tarifa – Standarde- Shërbime;
- Staf jo i kualifikuar sa dhe si duhet, për të menaxhuar dhe administruar shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve;
- Pa aftësia paguese e lartë;
- Niveli i arkëtimeve vazhdon të jetë i ulët;
- Bashkëpunimi ndër institucional, jo në nivelin e duhur.

## Konkluzionet dhe Rekomadimet

### Konkluzionet

Duke u bazuar në analizë mësipërme konkludojmë se kuadrin institucional dhe ligjor të menaxhimit të burimeve ujore:

#### Nivel Kombëtar

Në Shqipëri ekziston një hierarki institucionale, e cila merr vendime në lidhje mbrojtjen, monitorimin, vlerësimin dhe politikat për menaxhimin e ujit. Ligjshmëria Ujore bazohet në Ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”.

Nga pikëpamja institucionale- menaxhimi i burimeve ujore në Shqipëri është pothuajse i centralizuar, ndryshime e shpeshta, kanë çuar në mbivendosjen e përgjegjësive ndërmjet instituteve të nivelit qendror dhe atij vendor, gjë që ka rezultuar në një sektor ujor të fragmentuar, me veprimtari joefikase dhe mungesë transparence.

Nga pikëpamja ligjore- ligji Nr. 111/2012 është një bazë e rëndësishëm për menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri, gjithsesi sistemit Shqiptar i mungon legjislativi përkatës dytësor, përsa i përket mekanizmave që duhet të përdoren me qëllim ofrimin e një sektori efektiv dhe të integruar të ujit.

Të dhënat dhe informacionet- Për hartimin e politikave në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore, mungojnë të dhënat konsistente.

Angazhimi grupeve të interesit - në lidhje me hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore nuk është i vazhdueshëm dhe përfaqësues i të gjithë grupeve të interesit.

Investimet- Burimet kryesore të financimit për shoqëritë me shpërndarjen e ujit, kanë qenë buxheti i shtetit dhe financimi nga donatorët e huaj në formën e huave apo granteve në raporte përafërsisht të barabarta. Këto investime janë fokusuar kryesisht në rehabilitimin e sistemeve të furnizimit ujësor kanalizime si edhe në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Analiza dhe vlerësimi i kostove për zbatimin e investimeve të mëdha të Direktivave të BE-së, me fokus trajtimin e ujërave të ndotura urbane, ofrimin e ujit të pijshëm dhe menaxhimin e rrezeve të përmbajtjeve. Krijimi i një sistemi tarifash administrative efektive dhe të barabarta do të sigurojë se mangësia e financimit të ulet efektivisht në nivel të Basenit Ujor.

#### Nivel lokal

Sektori i Ujësor- Kanalizimeve në Kukës është zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme, ndonëse nivelet dhe ecuria e treguesve nuk është e duhura krahasuar me objektivat strategjike për sektorin dhe ato të performancës së mirë të ERU.

Shqetësimi kryesor në sektor është *niveli i ulët i arkëtimit dhe i matjes së prodhimit dhe konsumit të ujit*, tregues të cili nuk ka pasur një përmirësim të dukshëm. Të dy këto tregues janë të lidhur me nivelin e humbjeve në rrjet ose “Uji pa të ardhura”.

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë ka pasur tendencë pozitive por shërbimi i kanalizimeve vazhdon të mbetet prapa si për sa i përket mbulimit po ashtu edhe nivelit të kërkuar të shërbimit për të mundësuar mbrojtjen e ujërave dhe të mjedisit.

## **Rekomandime**

**Të plotësohet legjislacioni përkatës dytësor**, përse i përket mekanizmave që duhet të përdoren me qëllim ofrimin e një sektori efektiv dhe të integruar të ujit.

**Të dhënat dhe informacionet**- Për hartimin e politikave në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore, duke u bazuar edhe në parimet e OECD, të dhënave dhe informacionet përkatëse për ujin duhet të jenë konsistente, të krahasueshme dhe të shkëmbyeshme.

**Angazhimi grupeve të interesit**- në lidhje me hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore duhet të jetë i vazhdueshëm, ku përfshihen të gjitha grupet e interesit.

**Të rritet niveli i arkëtimeve**, menaxhimi i lidhjeve të paligjshme

## Referencat

Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2017 [\[link\]](#)

Ligji Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore [\[link\]](#)

Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030 [\[link\]](#)

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kukës (Plani i zhvillimit) [\[link\]](#)

Porta Vendore.al, Sistemet e Ujitjes & Kullimit [\[link\]](#)

Shoqeria UK Kukës, faqe online [\[link\]](#)

Enti Rregullator i Ujit, faqe online [\[link\]](#)

Parimet e OECD-s për Menaxhimin Ujërave (2015) [\[link\]](#)

## Anekset

### **Parimet e Kuadrit të OECD për Menaxhimin e Ujërave përfshijnë:**

**Parimi 1:** Cakton dhe dallon qartësisht rolet dhe përgjegjësitë për politikëbërjen për ujin, zbatimin e politikës, menaxhimin dhe rregullimin operacional, dhe nxitjen e koordinimit me këto autoritete përgjegjëse;

**Parimi 2:** Menaxhon ujin në shkallën(t) e duhur brenda sistemeve të menaxhimit të integruar të basenit për të reflektuar kushtet vendore dhe për të nxitur koordinimin ndërmjet shkallëve të ndryshme;

**Parimi 3:** Nxit koherencën për politika nëpërmjet koordinimit ndërsektorial efektiv, veçanërisht ndërmjet politikave për ujin dhe mjedisin, shëndetin, energjinë, bujqësinë, industrinë, planifikimin e hapësirës dhe përdorimin e tokës;

**Parimi 4:** Përshtat nivelin e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për ndërlkueshmërinë e sfidave të ujit që duhen përmbushur, dhe setin e kompetencave që kërkohen për kryerjen e detyrave të tyre;

**Parimi 5:** Prodhon, përditëson dhe ndan në kohë të dhëna dhe informacione të vazhdueshme, të krahasueshme dhe që lidhen me politikën dhe me ujin, dhe e përdor atë për të orientuar, vlerësuar dhe përmirësuar politikën e ujit;

**Parimi 6:** Siguron se rregullimet e qeverisjes ndihmojnë për mobilizimin e financave ujore dhe akordimin e burimeve financiare në mënyrë efikase, transparente dhe në kohë;

**Parimi 7:** Siguron se kornizat e shëndosha për menaxhimin e ujërave zbatohen në mënyrë efektive dhe përforcohen në ndjekje të interesit publik;

**Parimi 8:** Promovon miratimin dhe zbatimin e praktikave novatore për menaxhimin e ujërave me autoritetet përgjegjëse, nivelet e qeverisë dhe aktorët përkatës;

**Parimi 9:** Ruan integritetin dhe praktikën e transparencës për politikën e ujit, institucionet e ujit dhe kornizat për menaxhimin e ujërave për llogaridhënie më të madhe dhe besim në vendimmarrje;

**Parimi 10:** Promovon angazhimin e palëve të interesit për kontribute të informuara dhe të orientuara nga rezultatet për projektimin dhe zbatimin e politikës së ujit;

**Parimi 11:** Nxit kornizat për menaxhimin e ujërave që ndihmojnë në menaxhimin e balancimit ndërmjet përdoruesve të ujit, zonave rurale dhe urbane, dhe brezave;

**Parimi 12:** Promovon monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të politikës dhe menaxhimit të ujit kur është e mundur, ndan rezultatet me publikun dhe bërjen e rregullimeve të nevojshme.